



**Republika e Kosovës**

**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

Qeveria - Vlada - Government

**Ministria e Tregtisë dhe Industrisë**

**Ministarstvo Trgovine i Industrije - Ministry of Trade and Industry**

**Departamenti i Industrisë / Department Industrije/ Department of Industry**

# **RAPORTI PËR ZHVILLIMET NË INDUSTRIJËN E KOSOVËS, 2017**

Volumi i VI-të

Tetor, 2018

## **Përmbajtja**

<b>1. Lista e shkurtesave të përdorura.....</b>	.....
<b>2. Hyrje.....</b>	.....
<b>3. Metodologjia.....</b>	.....
<b>4. Analiza Sektoriale 2017.....</b>	.....
4.1 Qarkullimi vjetor, të punësuarit dhe ndërmarrjet prodhuese.....	.....
4.2 Numri i të punësuarve sipas sektorëve të prodhimit industrial në nivel të Kosovës, 2012-2017.....	.....
4.3 Numri i ndërmarrjeve sipas sektorëve industrial në Kosovë, 2012-2017.....	.....
<b>5. Analiza makroekonomike.....</b>	.....
5.1 Bruto produkti Vendor.....	.....
5.2 Struktura e përgjithshme e të Hyrave të Qeverisë 2016-2017.....	.....
5.3 Investimet e Huaja Direkte (IHD) në Kosovë.....	.....
5.4 Investimet e Huaja Direkte sipas aktivitetit ekonomik.....	.....
5.5 Investimet e Huaja Direkte (IHD) sipas Shteteve.....	.....
5.6 Tregu financiar.....	.....
5.7 Indeksi i çmimeve.....	.....
5.8 Tregtia e jashtme.....	.....
5.9 Fuqia punëtore.....	.....
<b>6. Konkluzione.....</b>	.....

## Lista e shkurtesave

ASK	-	Agjencia e Statistikave të Kosovës
ATK	-	Administrata Tatimore e Kosovës
BE	-	Bashkimi Evropian
BKK	-	Buxheti i Konsoliduar i Kosovës
BPV	-	Bruto Prodhimi Vendor
BQK	-	Banka Qendrore e Kosovës
DI	-	Departamenti i Industrisë
DK	-	Dogana e Kosovës
DPI	-	Divizioni për Zhvillimin e Politikave Industriale
IHD	-	Investimet e Huaja Direkte
IÇK	-	Indeksi i Çmimeve të Konsumit
IÇP	-	Indeksi i Çmimeve të Prodhimit
MTI	-	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
MTLEQ	-	Marrëveshja e Tregtisë së Lirë e Evropës Qendrore
NMVID	-	Norma Mesatare Vjetore e Interetit në Depozita
NMVIK	-	Norma Mesatare Vjetore e Interetit në Kredi
KTD	-	Korporata Tjera Depozituese

## Hyrja

Divizioni për Politika Industriale (DPI), në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë (MTI), ka përgatitur raportin vjetor statistikor dhe analitik për zhvillimet të sektorëve industrial në Kosovë.

Qëllimi i hartimit të Raportit Vjetor është paraqitja e trendëve kryesore të zhvillimit të ekonomisë së Kosovës, me theks të veçantë në sektorët kryesore industriale, gjatë vitit 2017, por edhe një analizë krahasuese për dy vitet e fundit si dhe trendi i zhvillimeve në sektorët e industrisë për periudhën kohore 2012-2017.

Paraqitja e të dhënave në këtë Raport mund t'iu shërbejë politikë-bërësve në procesin e zhvillimit ekonomik në Kosovë, bizneseve operuese, (të tanishme dhe ato potenciale nga sektori privat), investitorëve të huaj, donatorëve, hulumtuesve, akademikëve, etj. Më konkretisht, përmes këtij Raporti, i cili ofron një pasqyrë më të qartë rreth trendëve kryesore me ndikim në industrinë e vendit, do t'iu lehtësohet puna të gjithë akterëve përkatës në hartimin e politikave zhvillimore më të efektshme, bazuar në indikatorë të matshëm.

Përveç indikatorëve kryesor të nivelit sektorial/industrial (qarkullimi, numri i të punësuarave, ndërmarrjeve etj.), të cilët ndikojnë në zhvillimin industrial, në këtë raport janë përfshirë edhe indikatorët e nivelit makroekonomik, ata të tregut financiar, tregut të punës, pastaj Investimeve të Huaja Direkte si dhe tregtia e jashtme.

## **Metodologjia**

Raportit për zhvillimet në industrinë e Kosovës, për vitin 2017, është përshkruar dhe analizuar nga analistët e DPI-së të cilët kanë vënë në pah trendët kryesore në fushën e zhvillimit industrial në Kosovë.

Ky raport përshkruan zhvillimin e sektorëve ekonomik në vitin 2017, që do të thotë se fokusi i tij bie mbi këtë kohë, por trendët e indikatorëve të paraqitur përfshinë periudhën krahasuese në dy vitet e fundit si dhe atë gjashtë vjeçare 2012-2017.

Të dhënat janë mbledhur nga institucionet përgjegjëse (ASK, ARBK, ATK, BQK), kurse përpunimi, paraqitja grafike dhe analizimi i tyre është bërë nga Departamenti i Industrisë, përkatësisht, Divizioni për Politika Industriale.

## **Analiza Sektoriale 2017**

### **Qarkullimi vjetor, të punësuarit dhe ndërmarrjet prodhuese**

Analiza sektoriale në këtë raport përfshinë industrinë përpunuese, sipas NACE REV2, sektorët e radhitur sipas kodeve, 10 deri në 33, e që ka të bëjë me numrin e ndërmarrjeve prodhuese, pastaj numrin e të punësuarve si dhe vlerën e qarkullimit vjetor në këta sektorë. Përveç paraqitjes së të dhënave statistikore, analizat tregojnë edhe për trendët e rënies apo ngritjes, për këta indikatorë, në sektorët e industrisë, jo vetëm në vitin e fundit por edhe për periudhën krahasuese me vitin paraprak si dhe trendët në periudhën gjashtë vjeçare.

Nga analiza e këtyre të dhënave, sa i përket qarkullimit vjetor për vitin 2017, shohim se përpunimi i produkteve ushqimore (10) ka pasur përqindjen më të lartë, 21.8%, të qarkullimit në krahasim me sektorët e tjerë përpunues. Gjithashtu gjatë këtij viti, ky sektor, shënon përqindjen më të lartë, 23.2% dhe mbetet lider sa i përket numrit të punësuarve si dhe numrit të ndërmarrjeve prodhuese me 26.2%.

Në vendin e dytë, radhitet sektori i prodhimit të produkteve minerale jo metalike, për nga vlera e qarkullimit vjetor me 21.7%, po ashtu edhe për nga numri i të punësuarve me 16.4%, përderisa tek numri i ndërmarrjeve prodhuese ky sektor zë vendin e katërt.

Një ulje e dukshme e vlerës së qarkullimit vërehet te sektori i prodhimit të gomës dhe plastikës me 10.6% nga 14.2% sa ishte në vitin paraprak. Ky sektor, që në listën e sektorëve të industrisë përpunuese, për nga vlera e qarkullimit, radhitet në vendin e tretë, ka shënuar një rritje të vogël, me 0,1 %, të numrit të ndërmarrjeve, ndërsa sa i përket numrit të punësuarve ka ulje për 0.7% në krahasim me vitin e kaluar.

Të dhënat e paraqitura në tabelën nr. 1, tregojnë se sektori i prodhimeve të drurit dhe produkteve të drurit të tapës, radhitet në vendin e tetë me 3.4% të qarkullimit, por sa i përket numrit të ndërmarrjeve me 9.6%. zë një vend të rëndësishëm në tabelë. Kur jemi te ky sektor, shohim se prodhimi i mobileve është në një pozitë më të favorshme, ku vlera e qarkullimit është 4.8%. ndërsa ka shënuar 7.7% të pjesëmarrjes në numrin e përgjithshëm të të punësuarve në kuadër sektorëve industrial dhe rritjen e numrit të ndërmarrjeve me 8.1%.

Vlera qarkulluese e sektorit të prodhimit të tekstilit, gjatë vitit 2017, është vetëm 1.6% e vlerës së përgjithshme, apo radhitet në vendin e 12 të tabelës, kurse si sektor qëndron pak më mirë me numrin e të punësuarve dhe ndërmarrjeve prodhuese, e cila radhitet në pozitën e 9.

I përfaqësohet me këtë është edhe sektori i veshjeve, por që ka një vlerë shumë të vogël të qarkullimit me vetëm 0.7%.

Prodhimi i Metaleve për vitin 2017 ka shënuar vlerën e qarkullimit prej 6.2 % ku radhitet në vendin e gjashtë dhe krahasuar me vitin 2016 ka shënuar rritje për 72% të vlerës së qarkullimit.

Tabela 1: Sektori i Industrisë përpunuese sipas NACE REV2 2017

SEKTORI C INDUSTRIJA PËRPUNUESE SIPAS NACE REV 2		Ndërmarrjet prodhuese		Numri i të punësuarave		Qarkullimi i vjetor	
		Vlera	%	Vlera	%	Vlera	%
10	Përpunimi i produkteve ushqimore	1,251	26.2	5,786	23.2	227,434,530	21.8
11	Prodhimi i pijeve	78	1.6	1,686	6.7	95,785,190	9.2
12	Prodhimi i produkteve të duhanit	1	0.0	80	0.3	0	0.0
13	Prodhimi i tekstilit	124	2.6	836	3.3	17,232,925	1.6
14	Prodhimi i veshjeve	217	4.5	746	3.0	7,426,218	0.7
15	Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkurës	35	0.7	428	1.7	6,672,866	0.6
16	Prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit dhe të tapës,	458	9.6	1,215	4.9	35,814,961	3.4
17	Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letrës	94	2.0	450	1.8	21,924,010	2.1
18	Shtypja dhe riprodhimi i mediave të incizuara	155	3.2	600	2.4	18,076,502	1.7
19	Prodhimi i koksit dhe produkteve të rafinuara të naftës	8	0.2	49	0.2	7,667,889	0.7
20	Prodhimi i produkteve kimike	97	2.0	585	2.3	22,094,876	2.1
21	Prodhimi i produkteve bazë farmaceutike dhe preparateve	9	0.2	219	0.9	4,007,664	0.4
22	Prodhimi i produkteve të gomës dhe të plastikës	488	10.2	2,320	9.3	110,300,484	10.6
23	Prodhimi i produkteve minerale jometalike	476	10.0	4,098	16.4	226,562,793	21.7
24	Prodhimi i metaleve	102	2.1	1,039	4.2	65,106,448	6.2
25	Prodhimi i produkteve të fabrikua metalike	575	12.1	2,279	9.1	94,838,130	9.1
26	Prodhimi i kompjuterëve, produkteve elektronike dhe optike	23	0.5	48	0.2	2,325,824	0.2
27	Prodhimi i pajisjeve elektrike	37	0.8	191	0.8	8,568,449	0.8
28	Prodhimi i makinerisë dhe pajisjeve p.k.t.	25	0.5	104	0.4	7,199,149	0.7
29	Prodhimi i mjeteve motorike, rimorkiove dhe gjysmërimorkiove	2	0.0	31	0.1	783,531	0.1
30	Prodhimi i mjeteve të tjera të transportit	3	0.1	49	0.2	3,334,519	0.3
31	Prodhimi i mobilieve	385	8.1	1,915	7.7	50,079,842	4.8
32	Prodhimi tjetër p.k.t.	80	1.7	172	0.7	3,686,814	0.4
33	Riparimi dhe instalimi i makinerive dhe pajisjeve	47	1.0	62	0.2	7,547,275	0.7
	<b>Gjithsej</b>	<b>4,770</b>	<b>100.0</b>	<b>24,988</b>	<b>100.0</b>	<b>1,044,470,889</b>	<b>100.0</b>

Burimi: Të dhënat nga ASK, përpunuar nga DPI/ MTI

## Numri i të punësuarve sipas sektorëve të prodhimit industrial në Kosovë

Analiza e të dhënave, sa i përket numrit të punësuarve, në sektorët industrial, përgjatë viteve 2012-2017, tregon se sektori i përpunimit të produkteve ushqimore është sektori me numër më të madhe të punësuarve në Kosovë dhe se ky sektor ka ruajtur një trend të rritjes së të punësuarve përgjatë kësaj periudhe raportuese. Të dhënat tregojnë se në vitin 2017 është shënuar një rritje prej 6.4 % apo me 346 të punësuar më shumë në sektorin e produkteve ushqimore, krahasuar me një vit më parë. Kjo e dhënë tregon për një balancim të këtij sektori pasi që një rritje më e madhe e të punësuarve, prej 29.64%, ishte në vitin 2013, ndërsa një vit më vonë, që do të thotë në vitin 2014 ishte shënuar rënia më e madhe e të punësuarve, për 21.8 %.


Prodhimi i produkteve minerale jo-metalike, gjithashtu rezulton si sektor në të cilin janë të punësuar një numër më i madhe i punëtorëve. Të dhënat nëpër vite tregojnë se kemi rënie të lehtë për 2%, apo nga 18.9%, sa ishte në vitin 2012, në 16.4% në vitin e fundit.

Përgjatë vitit 2017, është shënuar rënie e numrit të punësuarve, edhe pse jo e madhe, në dy sektorë, në atë të prodhimit të produkteve të gomës dhe të plastikës, nga 10% në 9.3% dhe tek sektori i prodhimeve të produkteve të fabrikua metalike, përveç makinerisë dhe pajisjeve nga 9.7% në 9.1%

Sektori i prodhimit të drurit dhe produkteve të drurit dhe të tapës është njëri ndër sektorët i cili ka kontribuar në punësimin e punëtorëve në Kosovë, në vazhdimësi. Nga numri i përgjithshëm i të punësuarve në këtë sektor, në vitin 2012 ishin të punësuar 6.5%. Ky trend është ruajtur edhe në vitet në vijim, por në tre vitet e fundit vërehet një rënie e lehtë.

Një trend të ngjashëm, të rënies, e vërejmë edhe te sektori i prodhimeve të tekstitit, me rreth 4.5% të punësuarve, në tri vitet e para, 2012-2014, por rënie kishte edhe në vitin 2016, në 3.2%. Për dallim nga vitet e mëparshme, në vitin 2017 është shënuar një rritje e lehtë për 0.1%.

Fig. 1. Numri i të punësuarve sipas sektorëve të prodhimit industrial në nivel Kosove sipas viteve, 2012-2017



Burimi: Të dhënat nga ASK, përpunuar nga DPI/ MTI




## Numri i ndërmarrjeve sipas sektorëve industrial në Kosovë

Të dhënat për përqendrimin e ndërmarrjeve nëpër sektorë të ndryshëm industrial, sa i përket radhitjes së sektorëve, tregojnë se nuk kemi një luhajtje të numrit të ndërmarrjeve në këto gjashtë vite, 2012-2017. Viti 2013 dhe 2017 kanë shënuar shifrën prej rreth 4,770 ndërmarrje, përderisa një shifër më e lartë është shënuar në vitin 2014 me 5,259 ndërmarrje në sektorët industrial.

Të dhënat e paraqitura në figurën nr. 2, tregojnë se përqendrimi më i madh i ndërmarrjeve prodhuese, në vitin 2017, është në rajonin e Gjilanit, me 1204 ndërmarrje pasuar nga rajoni i Prishtinës me 1,185 sosh, pastaj Prizreni me 1,052 dhe me numër më të vogël është rajoni i Mitrovicës, me 387 ndërmarrje.

Numri më i madhe i të punësuarve është në rajonin e Prishtinës, me 6,660 të punësuar. Analizat e të dhënave tregojnë se në rajonet tjera të Kosovës kemi një paralele të ngjashme në mes të numrit të ndërmarrjeve dhe të punësuarve.

Fig. 2. Numri i ndërmarrjeve, 2017, sipas rajoneve në Kosovë



Burimi: Të dhënat nga ASK, përpunuar nga DPI/ MTI

## Analiza makroekonomike

### Bruto Produkti Vendor

Gjatë vitit 2017, Ekonomia e Kosovës shënoi një rritje në krahasim me vitin e kaluar, shikuar nga çmimi aktual, siç shihet në tabelën nr 2. Në fakt, BPV u rrit për 297 milion euro, dhe me këtë rast vlera totale e saj u rrit nga 5.985 milion euro, sa ishte në vitin 2016, në 6.282 milion euro në vitin 2017.


Tabela 2: BPV, 2012-2017

Viti	BPV (me çmime aktuale, në milion euro)	Ndryshimi vjetor i BPV-së (me çmime aktuale, në milion euro)
2012	5,059	244
2013	5,327	268
2014	5,567	240
2015	5,771	204
2016	5,985	214
2017	6,282	297

Burimi: Të dhënat nga ASK, përpunuar nga DPI/ MTI

Ashtu siç mund të shihet në Figurën 3, përgjatë gjashtë viteve të fundit, BPV me çmimet aktuale në milion euro kishte shënuar një trend pozitiv, duke shënuar rritjen më të lartë (6.28%) në vitin 2017. Shkalla e rritjes së BPV-së për vitin 2017 është 4.9% në krahasim me vitin e kaluar.

Figura 3: Norma e rritjes së BPV-së



Burimi: Të dhënat nga ASK, përpunuar nga DPI/ MTI

Kontribuuesit kryesor në BPV-në gjatë vitit 2017, kanë vazhduar të kenë rritje, duke filluar me shpenzimet e konsumit final të ekonomive familjare, ndjekur nga kapitali bruto i formuar si dhe eksporti i mallrave dhe shërbimeve.

Tabela 3: Struktura e BPV-së sipas shpenzimeve 2012-2017 (në milion euro)

Vitet	2017	2016	2015	2014	2013	2012
Shpenzimet e konsumit final	6,146.10	6,060	5,858	5,731	5,331	5,320
Shpenzimet e konsumit final të ekonomive shtëpiake & IJPSHESH	5,293	5,176	4,964	4,821	4,467	4,478
Shpenzimet e konsumit final të Qeverisë	853	884	894	910	864	842
Formimi i Bruto Kapitalit	1,819	1,651	1,601	1,435	1,471	1,465
Eksporti neto	(1,683)	(1,726)	(1,652)	(1,599)	(1,476)	(1,727)
Eksporti I mallrave dhe shërbimeve	1,696	1,346	1,274	1,253	1,167	922
Importi I mallrave dhe shërbimeve	3,380	3,072	2,926	2,852	2,642	2,649
BPV	6,282	5,985	5,807	5,568	5,327	5,059

Burimi: Të dhënat nga ASK, përpunuar nga DPI/ MTI


Në vitin 2017, vlera e eksportit të mallrave dhe shërbimeve u rrit për 350 milion euro, si dhe ajo e importit për 308 milion euro, në krahasim me vitin paraprak, ndërsa ka rezultuar me një deficit tregtar më të lartë prej 42 milion euro.

Në anën tjetër, vlera e Bruto Kapitalit u rrit për rreth 168 milion euro, përdërisa shpenzimet e Qeverisë u zvogëluan për 31 milion euro.

Ndërkaq, komponenti kryesor makroekonomik që ndikoi negativisht në vlerën e përgjithshme të BPV-së, ashtu sikurse edhe në vitet paraprake, ishte importi i mallrave dhe shërbimeve, që përfaqësojnë 52% të BPV-së.

Në Figurën 4, shihen komponentët kryesorë të BPV-së gjatë vitit 2017 dhe vlen të theksohet se nuk vërehet ndonjë ndryshim në renditjen e tyre, shikuar nga këndi i pjesëmarrjes se tyre në vlerën e përgjithshme të BPV-së. Sidoqoftë, trendët e vlerave të atyre komponentëve ishin të ndryshëm.

Figura 4: Komponentët e BPV-së, sipas qasjes së shpenzimeve, 2017



Burimi: Të dhënat nga ASK, përpunuar nga DPI / MTI

## Struktura e përgjithshme e të Hyrave të Qeverisë 2016-2017

Struktura e të hyrave qeveritare, që përfshinë dymbëdhjetë kategori, përgjatë vitit 2017, krahasuar me vitin paraprak, pësoi disa luhatje në kuadër të disa kategorive të caktuara. Më saktësisht, ngritjet më të mëdha të të hyrave ishin në kategorinë e tatimeve në produkte (79.8 milion euro), e që ishte rezultat i ngritjes së të hyrave kryesisht nga TVSH (47.8 milion euro). Gjithashtu ngritje kishte edhe te kategoria - tatimi dhe dogana në importe duke përjashtuar TVSH-në (23.9 milion euro), pastaj te kategoria e aktiviteteve dhe detyrimeve financiare (57.2 milion euro) si dhe kemi një rritje më të lehtë te pagesat për shitjet për 7.6 milion euro

Një rënie e të hyrave qeveritare, është shënuar në kategorinë e tatimeve rrjedhëse në të ardhura, pasuri, etj. (2.9 milion euro), pastaj te kategoria transferet e tjera aktuale (1.4 milion euro) si dhe te kategoria e tatimeve tjera në prodhim (0.1 milion euro)

Tabela 4: Struktura e përgjithshme e të Hyrave të Qeverisë 2016-2017


Kategoria e te hyrave	2016	2017
Tatimet në produkte	1,220.1	1,299.9
Tatimi mbi vlerën e shtuar(TVSH)	664.4	712.2
Tatimi dhe dogana ne importe duke përjashtuar TVSH	527.4	551.3
Detyrimet e importit	129.9	126.5
Taksat për importet pa TVSH dhe detyrimet	397.5	424.7
Tatimi mbi produktet, me përjashtim të TVSH-së dhe tatimet e importit	28.3	36.5
Tatimet tjera në prodhim	46.4	46.3
Të hyrat nga prona	7.2	9.4
Tatimet rrjedhëse në të ardhura, pasuri, etj.	236.0	233.1
Transferet tjera aktuale	23.1	21.7
Aktivitetet dhe detyrimet financiare	154.8	212
Pagesat për output jo-tregut (Shitjet)	91.7	98.6
Gjithsej	1,779.3	1.921.2

Burimi: Të dhënat nga ASK, të përpunuara nga DPI/ MTI

## Investimet e Huaja Direkte (IHD) në Kosovë

Investimet e Huaja Direkte në Kosovë, gjatë vitit 2017 kanë shënuar rritje prej 71.9 milion euro, krahasuar me vitin 2016. Ashtu siç mund të vërehet në Figurën nr. 5, gjatë këtyre viteve, 2012-2017, një rritje më e madhe është shënuar në vitin 2015.

Figura 5: Investimet e Huaja Direkte (në milion euro)



Burimi: Të dhënat nga ASK, përpunuar nga DPI / MTI

### Investimet e Huaja Direkte sipas aktivitetit ekonomik

Investimet e Huaja Direkte në Kosovë gjatë vitit 2017 arritën vlerën prej 287.8 milion euro, siç shihet në Tabelën nr. 5. Sektori më tërheqës për investimet e huaja direkte, edhe përgjatë këtij viti, ishte ai i patundshmërive, i cili arriti të tërheq rreth 65% të vlerës së përgjithshme të investimeve. Sektorë tjetër i cili ka tërhequr IHD-ve ishte ai i ndërtimitarisë me 15%, ndjekur nga sektori i shërbimeve financiare me 19%, të vlerës së përgjithshme.

Në të njëjtën kohë, krahasuar me vitin paraprak, vlera më e lartë e IHD-ve ishte në sektorin e shërbimeve financiare me 55.3 milion euro, apo për 36.3 milion euro më tepër se sa në vitin 2016, ndjekur nga ai i patundshmërive me vlerë më të lartë për 19.7 milion euro, e më pastaj edhe ai i ndërtimitarisë me 16.5 milion euro.

Tabela 5: IHD sipas sektorëve ekonomike, 2012 – 2017 (në milion euro)


Sektori	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Bujqësia	0.3	0.4	0.2	1.0	1.5	-1.3
Minierat	-25.0	-14.1	4.2	-36.9	-22.1	-4.9
Industria	27.4	11.5	-34.0	20.7	5.3	-2.7
Energjia	2.2	48.8	13.4	11.9	3.4	-1.0
Ndërtimtaria	31.1	17.3	-19.9	46.3	28.2	44.7
Shërbimet tregtare	9.3	14.6	8.4	12.0	12.8	9.8
Hotelet	0.5	0.8	0.4	0.0	0.7	0.8
Transporti dhe Komunikimi	32.4	51.0	-9.1	-6.1	-9.4	-6.6
Shërbimet financiare	22.4	4.4	41.9	64.3	19.0	55.3
Patundshmëritë	115.7	136.1	142.1	189.6	167.6	187.3
Shërbimet tjera	1.8	3.3	2.2	4.5	9.4	4.9
Aktivitetet tjera	11.0	6.2	1.4	1.4	-0.6	1.5
Gjithsej	229.1	280.2	151.2	308.8	215.9	287.8

Burimi: Të dhënat nga ASK, përpunuar nga DPI / MTI

Siç shihet në figurën 6, vlera e IHD-ve gjatë vitit 2017 në sektorët e industrisë, ka pasur një rënie të dukshme në -2.7 milion euro, krahasuar me vitin 2016, e që ishte 5.3 milion euro.

Gjatë këtyre viteve rënie më e madhe vërehet në vitin 2014 me -34 milion euro.

Figura 6: IHD, 2012-2017



Burimi: Të dhënat nga ASK, përpunuar nga DPI/ MTI

### Investimet e Huaja Direkte (IHD) sipas Shteteve

Investimet e huaja direkte sipas shteteve, gjatë viteve 2012-2017 kanë shënuar ndryshime të vazhdueshme. Vlera e përgjithshme e IHD-ve për vitin 2017 ishte 287,8 milion euro, që do të thotë se është shënuar një rritje prej 71,9 milion euro, krahasuar me vitin paraprak.

Rritja më e madhe e IHD është shënuar me Anglinë, për 39.7, pasuar nga Gjermania me një rritje nga 25.7 milion euro në 55.9 milion/euro, sa i kishte një vit më parë.

Gjatë vitit 2017, krahasuar me vitin 2016, shënuan rënie relativisht të dukshme në këto shtete: Zvicra, Turqia, Shqipëria. Sidoqoftë, analizuar në terme nominale, krahasuar me vitin paraprak, IHD-të që shënuan rënien më të madhe ishin ato prej shtetit të Shqipërisë nga 28.6 në 2.5 milion euro, apo për 26.1 milion euro, pasuar nga ato të shtetit të Turqisë me nga 44.4 milion euro në 29.4 milion euro.

Tabela 6: IHD sipas vendeve të origjinës, 2012 – 2017 (në milion euro)

Shtetet	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Anglia	14.3	10.7	-39.5	26.6	13.6	53.3
Austria	0.4	10.7	30.3	33.5	9.9	20.6
Bosnja	0	0.2	0.3	0.8	1.2	0.7
Bullgaria	8.1	5.6	14.5	1.6	0.4	0.5
Republika Ceke	0.3	0.2	0.4	1.3	0.2	0.7
Qipro	0.3	0.3	0.3	0.1	0.4	0.8
Egjipti	0.1	0	0.1	0	0	0
Estonia	0.2	0.2	0.1	-0.8	0.2	2.5
Emiratet Arabe	0.8	-0.8	1.3	1.4	3.5	13.4
Franca	6.3	3.8	3.3	3.2	2.8	3.5
Greqia	0.3	-0.4	-0.6	-0.2	-0.4	-0.4
Gjermania	49.5	21.7	29.4	45.3	25.7	55.9
Hungaria	0.4	1.3	1.1	0.1	-1.7	0.7
Holanda	-25.6	-0.1	-7.8	-36.4	-28.4	-14.1
Italia	4.4	8.7	3.3	5.7	1.9	7
Kuvajti	0.7	2	0.5	0	0.2	0
Kanada	1.2	1.2	0.9	1.1	2.5	3
Luksemburgu	0.8	2.3	1.2	0.1	0.6	1.8
Maqedonia	1.2	4.6	3.2	0.1	3.2	-1.7
Mali i Zi	4.3	3.1	0.1	0.1	0.1	0
Norvegjia	2.9	4.7	5.9	2.9	3.4	3.5
Rusia	0.4	5.7	2.4	0.8	-0.6	-1.4
Sllovakia	-	0.2	0.1	0.1	0.8	0.1
Slovenia	9.3	7	-9.4	5.6	-4.5	1.3
Shqipëria	4.7	19.3	20.4	40.1	28.6	2.5
SHBA	10.8	12.7	14.7	25	22.6	26.5
Turqia	65.6	88.6	20	55.4	44.4	29.4
Zvicra	43.8	41.7	38.2	72.9	61.8	50.6
Tjera	23.6	25.2	16.6	22.4	23.3	27.3
Gjithsej	229.1	280.2	151.2	308.8	215.9	287.8

Burimi. Të dhënat nga ASK, përpunuar nga DPI / MTI

## Tregu financiar


Sa i përket Normës Efektive të Interesit të KTD-ve në kredi, gjatë vitit 2017 u shënuar një rënie në të gjitha llojet e kredive në krahasim me vitin paraprak me një diferencë të normës mesatare të interesit për 0.78%.

Tabela 7: Norma Efektive të Interesit te KTD-ve në Kredi (%)

	Norma e Interesit 2016	Norma e Interesit 2017
Kredi Konsumuese	8.29	7.75
Kredi Hipotekare	6.54	5.94
Bujqësore	8.29	7.02
Industriale	7	6.37
Shërbyese	7.9	6.5
Sektorët Tjerë	6.78	6.56
Mesatarja e Normës se Interesit	7.47	6,69

Në vitin 2017, siç shihet në figurën 7, në krahasim me vitin paraprak, vërehet një rënie e normave të interesit, rënie me të madhe pati në kredit bujqësore me 1.27% duke e pasuar ajo shërbyese me 1.4%, kurse ajo hipotekare me 0.6%.

Figura 7: Normat e interesit, 2016-2017 (%)



Burimi: Të dhënat nga BQK, përpunuar nga DPI/ MTI



## Indeksi i Çmimeve

Indeksi i çmimeve të prodhimit shënoi një rritje relativisht të vogël gjatë vitit 2017, në 114,5 milion euro nga 113,8 milion euro, apo 0,6% krahasim me vitin paraprak. Poashtu rritje u shënuar edhe te Indeksi i Çmimeve të Importit për 4,5 milion euro, apo 4% si dhe te Indeksi i Çmimit të Konsumit për 1,5%, krahasuar me vitin paraprak.


Tabela 8: Indekset e çmimeve të prodhimit, konsumit dhe importit ( milion euro)

Viti	IÇP (2010 ë 100)	IÇI (2010ë100)	IÇK(2015 ë 100)
2012	106.6	115.0	98.4
2013	109.1	115.2	100.1
2014	110.9	114.7	100.5
2015	113.9	113.4	100
2016	113.8	110.5	100.3
2017	114.5	115.0	101.8

Burimi: Të dhënat nga ASK, përpunuar nga DPI/ MTI

Nga figura e mëposhtme mund të vërehet se kemi rritjen e të tre indekseve gjatë vitit 2017 në krahasime me vitet paraprake.

Figura 8: Ndryshimet vjetore të çmimeve të Prodhimit, Konsumit dhe Importit, 2012-2017



Burimi: Të dhënat nga ASK, përpunuar nga DPI/ MTI

## Tregtia e Jashtme

Të dhënat në tabelën 9 tregojnë se nga viti 2013 deri në vitin 2017, bilanci tregtar në Kosovë, imoport/eksport, është negativ.

Nëse analizojmë trendin e eksporteve vërejmë se viti 2017 ka pasur rritje në eksport për 23.5% krahasuar me vitin 2016, si dhe rritje është shënuar në import për 9.23%.

Viti 2017 tregon bilanc negativ prej 2 miliard e 669 milion euro krahasuar me vitin 2016, apo për 7.5%.

Tabela 9: Vlera e Eksporteve, Importeve dhe bilanci tregtar në Kosovë


Vitet	Eksportet	Importet	Bilanci Tregtar	Ndryshimi mes viteve në %
2013	293,842	2,449,064	-2,155,222	-3.4%
2014	324,543	2,538,337	-2,213,794	2.7%
2015	335,076	2,634,693	-2,299,617	3.9%
2016	306,053	2,789,490	-2,483,437	8.0%
2017	378,010	3,047,018	-2,669,008	7.5%

Burimi: Të dhënat nga ASK, përpunuar nga DPI/ MTI

Siç mund të vërehet edhe nga Figura 10, vlerat e importeve dominojnë ne krahasim me vlerat e eksporteve në tregtinë e jashtme të Kosovës.

Sektorët e industrisë përpunuese në Kosovë (metalike, tekstilit, drurit, industrisë kimike, plastikës dhe gomës, lëkurës, letrës dhe këpucëve) në vitin 2017 kane arritur të eksportojnë ne vlere prej 283,735,120 euro, ndërsa te importojnë në vlerë 1,482,885,664 euro.

Figura 9: Tregtia e jashtme 2017



Burimi: Të dhënat nga ASK, përpunuar nga DPI/ MTI

## Eksportet dhe Importet me vendet e CEFTA-së, BE-së dhe Vendet tjera 2016 - 2017

Të dhënat e paraqitura në tabelën nr. 10, paraqesin një pasqyrë të vlerave të importit dhe eksportit me vendet e CEFTA-së, BE-së dhe vendet e tjera për vitin 2016 dhe vitin 2017, ku vërehet se sektorët e ngjashëm të industrisë së Kosovës vazhdojnë ta dominojnë tregtinë e jashtme.

Eksportet gjatë vitit 2017 dominohen nga sektori i metaleve në vlerë prej 135,410,356 euro, kështu që krahasuar me vitin 2016 ky sektor, ka pasur rritje për 21.84%.

Ndërsa, vërejmë se sektori me rritjen më të lartë sa i përket eksporteve, për vitin 2017, është sektori i letrës me 31% krahasuar me vitin paraprak, në vendin e dytë radhitet sektori plastikës dhe gomës me rritje për 23.41%, kurse sektori i drurit me 21.81%. Ndërsa rënie në eksport, krahasuar me vitin paraprak, është shënuar në sektorin e këpucëve për 19.4%.

Importet vazhdojnë të dominohen nga sektori i industrisë kimike, duke shënuar vlerën prej 673,099,031 euro për vitin 2017, ku krahasuar me vitin paraprak, vlera e importeve për këtë sektor ka pasur rritje prej 22.59 %, e që rezulton të jetë më e larta për këtë vit.

Vendin e dytë, sa i përket importeve më të mëdha, e zë sektori metalit me një vlerë prej 307,104,786 euro, me një ngritje prej 11.52 % krahasuar me vitin paraprak. Sektori i letrës ka shënuar rritje në vlerë prej 46,072,496 euro për vitin 2017, apo 10.38% në krahasim me vitin 2016.

Në përgjithësi, vërejmë se vazhdojmë të kemi një deficit tregtar në tregtinë e jashtme në vlerë prej 1,199,150,544 euro. Megjithatë në vitin 2017 krahasuar me vitin 2016 eksportet janë rritur për 18.45%, kundrejt rritjes në vlerë të importeve me 13.43%.

Tabela 10: Vlera e Eksp. dhe Imp. me vendet e CEFTA-së, BE-së, dhe Vendet tjera 2016 - 2017

Artikujt sipas industrisë	Eksporti		Balanci		Importi		Balanci	
	2016	2017	VLERE 2017-2016	% 2017> 2016	2016	2017	VLERE 2017-2016	% 2017> 2016
Kimike	68,583,015	78,579,573	9,996,558	14.58	549,055,605	673,099,031	124,043,426	22.59
Plastik dhe gomë	28,871,840	35,629,898	6,758,058	23.41	188,422,517	194,267,121	5,844,603	3.10
Lëkurë	11,192,265	11,826,568	634,302	5.67	8,392,124	9,009,904	617,780	7.36
Drurit	3,618,533	4,407,867	789,334	21.81	72,641,885	77,186,306	4,544,421	6.26
Letër	3,977,220	5,210,018	1,232,798	31.00	41,741,640	46,072,496	4,330,856	10.38
Tekstilit	8,784,388	9,941,482	1,157,095	13.17	136,687,770	139,909,718	3,221,948	2.36
Këpucë etj.	3,371,240	2,729,359	(641,882)	(19.04)	35,017,027	36,236,302	1,219,274	3.48
Metaleve	111,141,960	135,410,356	24,268,396	21.84	275,383,592	307,104,786	31,721,195	11.52
<b>Gjithsej</b>	<b>239,540,462</b>	<b>283,735,120</b>	<b>44,194,659</b>	<b>18.45</b>	<b>1,307,342,161</b>	<b>1,482,885,664</b>	<b>175,543,503</b>	<b>13.43</b>

Burimi: Të dhënat nga ASK, përpunuar nga DPI/ MTI

## Eksporteve dhe Importeve me vendet e CEFTA-së për sektorët e industrisë, 2016 - 2017

Në tabelën numër 11 pasqyrohen vlerat e importit dhe eksportit me vendet e CEFTA-s për vitin 2017 dhe vitin paraprak për sektorët e industrisë kimike, plastikës-gomës, lëkurës, drurit, letrës, tekstilit, këpucëve dhe metalit. Vërejmë se janë po të njëjtët sektorë të industrisë së Kosovës të cilët vazhdojnë të dominojnë edhe tregtinë e jashtme me vendet e CEFTA-së.

Tabela 11: Vlera e Eksporteve dhe Importeve me vendet e CEFTA-së për sektorët e industrisë, 2016 - 2017

Artikujt sipas industrisë	Eksporti		Balanci		Importi		Balanci	
	2016	2017	VLERE 2017-2016	% 2017> 2016	2016	2017	VLERE 2017-2016	% 2017> 2016
Kimike	44,994,845	46,255,343	1,260,498	2.80	164,715,258	235,949,972	71,234,714	43.25
Plastik dhe gomë	9,532,071	13,203,656	3,671,584	38.52	42,575,654	39,652,417	(2,923,236)	(6.87)
Lëkurë	3,342,837	5,052,034	1,709,197	51.13	95,720	143,824	48,104	50.26
Drurit	1,029,611	1,597,993	568,382	55.20	29,477,410	33,142,025	3,664,616	12.43
Letre	2,997,419	4,135,765	1,138,347	37.98	17,273,454	18,645,335	1,371,881	7.94
Tekstilit	783,344	1,067,645	284,301	36.29	5,098,533	4,363,188	(735,345)	(14.42)
Këpucë etj.	1,473,694	1,530,855	57,161	3.88	1,849,701	1,804,797	(44,904)	(2.43)
Metaleve	41,711,114	61,639,118	19,928,004	47.78	152,696,633	178,467,389	25,770,756	16.88
<b>Gjithsej</b>	<b>105,864,934</b>	<b>134,482,410</b>	<b>28,617,475</b>	<b>27.03</b>	<b>413,782,363</b>	<b>512,168,948</b>	<b>98,386,585</b>	<b>23.78</b>

Burimi: Të dhënat nga ASK, përpunuar nga DPI/ MTI

Eksportet gjatë vitit 2017 dominohen nga sektori i industrisë kimike duke arritur vlerën prej 46,255,343 euro. Ndërsa, vërejmë se sektori me rritjen më të lartë sa i përket eksporteve, për vitin 2017, është sektori i drurit i cili ka eksportuar 55.20 %, më shumë krahasuar me vitin paraprak, në vendin e dytë radhitet sektori i lëkurës i cili ka rritur vlerën e eksporteve me 51.13 %, kurse sektori i metaleve me 47.78 %. Ndërsa rënie në eksport, krahasuar me vitin paraprak, është shënuar në sektorin e këpucëve për 3.88%.

Importet vazhdojnë të dominohen nga sektori kimik duke shënuar vlerën prej 235,949,972 euro për vitin 2017. Në vendin e dytë sa i përket importit radhitet sektori i metaleve me 178,467,389 euro. Ndërsa rritje më të madhe në import në vitin 2017 krahasuar me vitin paraprak ka pasur sektori i Lëkurës me 50.26 %, i përcjellë nga sektori i industrisë kimike me 43.25 %.

Duhet cekur në vitin 2017 krahasuar me vitin paraprak rënie ka pasur në sektorin e tekstilit 14.42 %, sektorin e plastikës dhe gomës me 6.87% dhe sektorin e këpucëve me një rënie prej 2.43%.

Në përgjithësi, vërejmë se vazhdojmë të kemi një deficit tregtar me vendet e CEFTA prej 377, 686,538 euro, megjithatë, eksportet për vitin 2017 në vlerë janë rritur me 27.03%, kundrejt rritjes së importeve me 23.78%.

## Eksportet dhe Importet me vendet e BE-së për vitin 2016– 2017

Eksportet me vendet e BE për vitin 2017 shënuan rritje për 26.39%, ndërsa importet vetëm për 11.14%, kështu që vazhdojmë të kemi një deficit tregtar me vendet e BE-së, në vlerë prej 495,828,806 euro.

Tabela 12: Vlera e Eksporteve dhe Importeve me vendet e BE-së për vitin 2016– 2017

Artikujt sipas industrisë	Eksporti		Balanci		Importi		Balanci	
	2016	2017	Ndryshimi	Ndryshimi %	2016	2017	Ndryshimi	Ndryshimi %
Kimike	14,575,414	27,048,279	12,472,864	85.57	303,937,708	346,524,601	42,586,893	14.01
Plastik dhe gomë	13,314,870	15,785,322	2,470,452	18.55	78,597,239	89,100,242	10,503,003	13.36
Lëkurë	7,728,689	6,773,815	(954,874)	(12.35)	1,436,804	989,350	(447,454)	(31.14)
Drurit	1,398,541	1,512,745	114,204	8.17	27,817,321	26,117,361	(1,699,960)	(6.11)
Letre	213,061	495,369	282,308	132.50	15,882,997	18,838,890	2,955,893	18.61
Tekstilit	2,800,035	3,656,276	856,240	30.58	12,040,183	12,058,571	18,387	0.15
Këpucë etj.	1,858,039	1,159,716	(698,324)	(37.58)	3,293,939	2,934,789	(359,151)	(10.90)
Metaleve	7,946,484	6,552,667	(1,393,816)	(17.54)	59,791,503	62,249,191	2,457,688	4.11
<b>Gjithsej</b>	<b>49,835,134</b>	<b>62,984,187</b>	<b>13,149,054</b>	<b>26.39</b>	<b>502,797,693</b>	<b>558,812,993</b>	<b>56,015,300</b>	<b>11.14</b>

Burimi: Të dhënat nga ASK, përpunuar nga DPI/ MTI

Industria kimike është sektori nga i cili është eksportuar më shumë gjatë viti 2017 me vendet e BE-së, duke arritur vlerën prej 27,048,279 euro, që do të thotë se ky sektor ka eksportuar 85.57% më shumë krahasuar me vitin paraprak. Në vendin e dytë, me rritjen me të lartë, sa i përket eksporteve për vitin 2017 është sektori i plastikës dhe gomës me 15,785,322 euro.

Krahasuar me vitin 2016 sektori i letrës ka rritje më të madhe prej 132.50%, i përcjellë nga sektori i produkteve të industrisë kimike që ishte me rritje prej 85.57%.

Gjatë vitit 2017 rënie në eksport ka pasur në sektorët: këpucëve me 37.58%, metaleve 17.54% dhe sektorin e lëkurës me 12.35%.

Sektori i industrisë kimike ka shënuar vlerën prej 346,524,601 euro dhe vazhdon të jetë dominues në import. Vendin e dytë, sa i përket importeve më të mëdha e zë sektori plastikë dhe gomë me një vlerë prej 89,100,242 euro. Krahasuar me vitin 2016 sektori i letrës ka treguar rritje në import për 18.61%.

Bilanci tregtar në sektorin e lëkurës është në nivel të kënaqshëm edhe pse është shënuar ulje në eksport për 12.35%, sepse ka rënie në import për 31.14%.

Bilanc jo të mirë në vitin 2017 krahasuar me vitin paraprak ka treguar sektori i këpucëve ku eksporti ka pasur ulje për 37.58% krahasuar me importin i cili ka pësuar ulje vetëm me 10.90%.

## Eksportet dhe Importet me vendet e tjera për vitin 2016 - 2017

Eksportet me vendet tjera për vitin 2017, kishin rënie për 68.6 % në krahasim me importet të cilat u rriten me 5.24 % , që do të thotë se vazhdojmë të kemi një deficit tregtar me vendet e tjera, me vlerë prej 380,821,390 euro.

Tabela 13: Vlera e Eksporteve dhe Importeve me vendet e tjera për vitin 2016 - 2017

Artikujt sipas industrisë	Eksporti		Balanci		Importi		Balanci	
	2016	2017	Ndryshimi	Ndryshimi %	2016	2017	Ndryshimi	Ndryshimi %
Kimik	9,012,756	5,245,015	(3,767,741)	(41.80)	76,626,683	85,865,459	9,238,776	12.06
Plastik dhe gomë	6,024,899	6,640,921	616,022	10.22	67,342,159	65,514,462	(1,827,697)	(2.71)
Lëkure	120,739	718	(120,021)	(99.41)	6,859,659	7,876,730	1,017,071	14.83
Druri	1,190,381	1,297,129	106,748	8.97	15,364,278	17,926,920	2,562,642	16.68
Letre	766,740	578,884	(187,856)	(24.50)	8,773,091	8,588,272	(184,819)	(2.11)
Tekstili	5,201,009	5,217,562	16,553	0.32	119,550,408	123,487,959	3,937,551	3.29
Këpucë etj.	39,507	38,788	(719)	(1.82)	29,871,117	31,496,716	1,625,599	5.44
Metaleve	61,484,363	7,304,318	(54,180,045)	(88.12)	62,501,332	66,388,206	3,886,874	6.22
<b>Gjithsej</b>	<b>83,840,394</b>	<b>26,323,334</b>	<b>(57,517,059)</b>	<b>(68.60)</b>	<b>386,888,726</b>	<b>407,144,724</b>	<b>20,255,998</b>	<b>5.24</b>

Burimi: Të dhënat nga ASK, përpunuar nga DPI/ MTI

Ne kuadër të eksporteve me vendet e tjera, gjatë viti 2017, rritje ka shënuar sektori i plastikës dhe gomës me 10.22 % dhe sektori i drurit me 8.97%.

Ndërsa sektori i metaleve edhe pse ka vlerën më të lartë në kuadër të eksporteve, prej 7,304,318 euro, ka shënuar rënie për 88.12 % krahasuar me vitin 2016. Rënie në eksport është shënuar edhe në sektorin e lëkurës me 99.41%, pastaj rënie të konsiderueshme ka pasur edhe të sektori i industrisë kimike me 41.80% si dhe industria e letrës me 24.5%.

Importin më i lartë, edhe në vitin 2017, është shënuar në sektorin e tekstit me vlerë prej 123,487,959 euro, ndërsa ndryshimi më i madhe në vlerën e importit, krahasuar me sektorët tjerë ka shënuar sektori i industrisë kimike me vlerë prej 9,238,459 euro.

Krahasuar me vitin 2016 rritje më të lartë në import ka pasur sektori i drurit për 16.68%, pastaj radhitet sektori i industrisë së lëkurës me 14.83%, sektori i industrisë kimike me 12.06% etj. Ndërsa rënie në import kanë shënuar sektori i industrisë së plastikës dhe gomës për 2.71% dhe sektori i letrës për 2.11%.

## Fuqia punëtore

Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore gjatë vitit 2017 arriti në 42.8%, krahasuar me vitin 2016 pjesëmarrja në fuqinë punëtore u rrit për 4.1%. Të dhënat tregojnë se rritja më e theksuar e shkallës së pjesëmarrjes në fuqinë punëtore rezultoi në rastin e meshkujve ku kishte një rritje prej 7% si dhe vetëm 1.4 % në rastin e pjesëmarrjes së femrave. Këto të dhëna tregojnë se ende vazhdojmë të kemi një shkallë të ultë të pjesëmarrjes së femrave në fuqinë punëtore, përkundër faktit që kemi një rritje të pjesëmarrjes së përgjithshme, krahasuar me pesë vitet e mëparshme.


Tabela 14: Pjesëmarrja në fuqinë punëtore 2012-2017 (%)

Viti	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Pjesëmarrja në fuqinë punëtore (në %)	36.9	40.5	41.6	37.6	38.7	42.8
Pjesëmarrja e femrave në fuqinë punëtore (në %)	17.8	21.1	21.4	18.1	18.6	20.0
Pjesëmarrja e meshkujve në fuqinë punëtore (në %)	55.4	60.2	61.8	56.7	58.3	65.3

Burimi: ASK

Nga Figura 11, mund të shihet që shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore gjatë gjashte viteve të fundit, ka pësuar luhatje nga viti në vit, duke konsideruar vlerën më të lartë prej 42.8% në vitin 2017.

Figura 10: Pjesëmarrja në fuqinë punëtore 2012-2017 (%)



Burimi: ASK

Papunësia më e lartë ishte në vitin 2014 me 35.3%, ndërsa më e ulëta ishte në vitin 2016 me 27.5%. Në vitin 2017 krahasuar me vitin 2016 papunësia është 30.5%, ku shënoi rritje për 3%.


Tabela 15: Shkalla e papunësisë 2012-2017 (%)

Viti	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Shkalla e përgjithshme e papunësisë (në %)	30	31	35.3	32.9	27.5	30.5
Shkalla e papunësisë tek femrat (në %)	38	40	41.6	36.6	31.8	36.6
Shkalla e papunësisë tek meshkujt (në %)	27	28	33.1	31.8	26.2	28.7

Burimi: ASK

Ashtu siç mund të shihet në Figurën 11, trendi i shkallës së papunësisë në krahasim me vitin paraprak shënoi një rritje. Vlen të theksohet që krahasuar me vitin paraprak, gjatë vitit 2017, shkalla e papunësisë tek femrat shënojë rritje nga 31.8 % në 36.6 %, ndërkaq tek meshkujt nga 26.2% në 28.7%.

Figura 11: Shkalla e papunësisë 2012-2017



Burimi: ASK



## Konkluzione:

- Gjatë vitit 2017, në sektorët e industrisë, kemi 4.770 ndërmarrje, me 24.988 të punësuar dhe me vlerë të qarkullimit prej 1,044.470 euro. Sektori i përpunimit të produkteve ushqimore (10) sa i përket qarkullimit vjetorë ka shënuar përqindjen më të lartë për 21.8%, në krahasim me sektorët e tjerë përpunues të NACE2. Gjithashtu me përqindjen më të lartë, 23.2% ky sektor mbetet lider sa i përket numrit të punësuarve si dhe numrit të ndërmarrjeve prodhuese me 26.2%.
- Numri i të punësuarve në vitet 2012-2017, ka shënuar rënie të lehtë në sektorët: e prodhimit të produkteve të gomës dhe sektorin e plastikës, nga 10% në 9.3%, dhe tek sektori i prodhimeve të produkteve të fabrikua metalike, përveç makinerisë dhe pajisjeve nga 9.7% në 9.1.
- Sektori me rritjen më të lartë, sa i përket eksporteve, për viti 2017, është sektori i letrës i cili e ka rritur vlerën e eksporteve me 31% krahasuar me vitin paraprak, kurse sektori i plastikës dhe gomës radhitet në vendin e dytë pasi që ka rritur vlerën e eksporteve për 23.41%. Rënie në eksport, për vitin 2017 krahasuar me vitin 2016 ka pasur sektori i Këpucëve për 19.04%.
- Import më të lartë ka sektori i industrisë kimike, krahasuar me vitin 2016 në vitin 2017 ka rritje për 22.59%.
- Vlera e përgjithshme e IHD-ve gjatë vitit 2017, krahasuar me vitin paraprak ka pësuar rritje relativisht të dukshme, me rreth 33%, rritje e IHD ka pasur pothuajse të gjitha shtetet e origjinës, shënoi rritje.
- Sa i përket normave të Interesit Bankar, gjatë vitit 2017 krahasuar me vitin paraprak shënuan rënie, po thuhet se në të gjitha llojet e kredive. Tri llojet e kredive me normën më të lartë të interesit ishin kreditë Konsumues, ndjekur nga ato Bujqësore, ndërsa interesi më i ulët ishte te sektori i shërbimeve.
- Çmimet e konsumit në Kosovë janë të dominuar, kryesisht, nga çmimet e importeve. Të dhënat tregojnë se oferta e mallrave dhe shërbimeve të importuara është jo-elastike ndaj kërkesës përkatëse vendore, ndërkohë që oferta nga prodhuesi i mallrave dhe shërbimeve të Kosovës ballafaqohet me çmime të prodhimit që shënojnë rritje të vazhdueshme, andaj është faktorë që ndikon në uljen e konkurrueshmërisë në tregun vendor.
- Shkalla e përgjithshme e papunësisë shënojë një rritje krahasuar me vitin paraprak nga 27.5% në 30.5 % në vitin 2017, që paraqet një rritje të shkallës së përgjithshme për 3%.